



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr 1700 prot

Përmet, më 26.05 2026

Lënda: Kth m Përgjigje

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; Ligji Nr. 119/14, "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar, nisur nga kërkesa juaj datë 11.05.2026, protokolluar me tonën me nr 1700 prot., datë 11.05.2026, ju vendosim në dispozicion informacionin si më poshtë:

1: Buxheti vjetor i miratuar për kulturën është Lekë dhe realizimi faktik sipas programeve buxhetore është e ndarë sipas:

	Programi buxhetor AD135	Plan	Fakt
1	Kap 1 8220	20 940 634	15 420 286
2	Kap 5 8220	2 500 000	2 380 510
-	Kap 2 8220	4 967 000	3 066 859

Më shumë informacion mund të gjeni në Programin e Transparences tek faqja zyrtare e bashkisë:

<https://bashkiapermet.gov.al/buxheti/>

2: Numri i aktiviteteve, festivaleve ose projekteve kulturore të mbështetura jo vetëm financiarisht nga bashkia numërohen rreth 100 aktivitete në vit. Bashkia Përmet tashmë prej disa vitesh realizon kalendarët mujor të aktiviteteve në të cilët përfshihen aktivitete kulturore, artistike, turistike dhe sociale. Të gjitha këto realizohen nga stafi pjesë e strukturës së Kulturës në Bashkinë Përmet, organizata kulturore të cilat zhvillojnë eventet në qytetin e Përmetit etj.

3: Bashkia Përmet realizon një procedurë prokurimi për aktivitetet kulturore-artistike vjetore, gjithashtu mbështet financiarisht kërkesat nga OJF të cilat zhvillojnë aktivitete që pasurojnë jetën

Sheshi "Abdyl Frashëri"; tel.+35581322254; web:www.bashkiapermet.gov.al; e-mail:info@bashkiapermet.gov.al

kulturore të qytetit. Në vitin 2025 fondi total për kulturën ishte 1 700 000 lekë nga të cilat rreth 50 % shkojnë për mbështetjen e eventeve të OJF-ve.

4: Institucionet kulturore në varësi të bashkisë janë: Kinemaja “13 Shtatori” me vendndodhjen në lagjen Varosh ku janë të punësuar 2 punonjës, Qendra Multifunkionale me vendndodhje në shëtitoren “Odhise Paskali” ku janë të punësuar 10 punonjës, Biblioteka e Qytetit “Lliko Nano” me vendndodhje Rruga” Laver Bariu” ku janë të punësuar 2 punonjës, Qendra Rinore “Ollga Shuraja” me vendndodhjen në Rrugën “Meleq Gosnnishti” ku janë të punësuar 2 punonjës, Qendra Kulturore e Fëmijëve pranë ambienteve të Qendrës Rinore , për të cilën janë angazhuar 2 punonjës dhe disa instruktorë të jashtëm part-time.

5: Numri i punonjësve të angazhuar në strukturat përgjegjëse për kulturën në bashki për cdo vit gjatë periudhës 2020-2025 është 15 punonjës. Kjo strukturë ka patur qëndrueshmëri në numër punonjësish ndër vite.

6: Objektet të trashëgimisë kulturore të restauruara në periudhën 2020-2025 kanë qënë 2, Kisha Shën e Premte dhe Ura e Katiut në fshatin Bënjë Përmet. Këto ndërhyrje janë realizuar me fonde të Ministrisë së Kulturës.

7: Bashkia Përmet nuk ka plane lokale apo dokument strategjik të miratuar por me VKB Nr. 86 datë 05.11.2024 është ngritur Këshilli Artistik i cili miraton programin kulturor vjetor dhe puna e tij bazohet në Ligjin Nr.540 datë 21.12.1992 si dhe Udhëzimit Nr.1 datë 24.05.2005 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillave artistiko-kulturor”.

8: Numri i konsultimeve publike të zhvilluara në lidhje me kulturën, trashëgiminë kulturore ose aktiviteteve kulturore gjatë periudhës 2020-2025 është rreth 6 cdo vite. Këto konsultime janë realizuar gjatë periudhës së hartimit të buxhetit të bashkisë për vitin pasardhës. Konsultimet kanë qënë me grupe të ndryshme interesi dhe institucione të tjera vendore, OJF etj.

9: Hapësirat publike të përdorura për aktiviteteve kulturore të përdorura gjatë periudhës 2020-2025 janë: Lapidari “Ushtar i Panjohur”, Sheshi “Abdyl Frashëri”, salla “Kongresi i Përmetit”, Qendra Multifunkionale “Odhise Paskali”, Kinema “13 Shtatori”, Qendra Rinore “Ollga Shuraja”.

10: Bashkia Përmet ka miratuar tarifa për përdorimin e sallave , hyrjen në Muzeun Vendor (i cili është drejt përfundimit të pavioneve), por Bashkia shpesh i ka parë si mënyrë mbështetje për zhvillimin e aktiviteteve.

11: Bashkia Përmet ka disa projekte në proces si përfundimi i punës për shtimin e pavioneve në Muzeun Vendor Përmet, Restaurimin e Lapidarit “Ushtari Panjohur” me mbështetjen e Këshillit të Qarkut, si dhe festa lokale tashmë traditë prej disa vitesh dhe zgjerimin e aktiviteteve në Njësitë Administrative.

12: Për gjatë periudhës 2020-2025 aktivitetet kulturore të shpërndara në njësitë administrative : 13 Gusht- Festa e fshatit Badlonjë,

14 Gusht- Festa e fshatit Kosinë,

15 Gusht – Festa e fshatit Qilarisht,

Sheshi “Abdyl Frashëri”; tel. +35581322254; web: www.bashkiapermet.gov.al; e-mail: info@bashkiapermet.gov.al

16 Gusht – Festa e fshatit Zhepë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA

Në mungesë dhe me porosi
SEKRETARI PËRGJITHSHËM
Denira DURRO



Sheshi "Abdyl Frashëri"; tel. +35581322254; web: www.bashkiapermet.gov.al; e-mail: info@bashkiapermet.gov.al